



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0858**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga zv.Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim, paneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "EJONA" SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDASHME në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi dhe montimi I chilereve te rinj dhe termopompave ne ndertesast qeveritare me numër të prokurimit 214-24-4897-1-1-1, me 20/11/2024, mori:

### **Vendim**

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE., "Ejona" Sh.P.K., me nr. 2024/0858, e datës 16/09/2024, kurse vendimi i AK Ministria e Punëve të Brendshme. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe montimi i chilereve te rinj dhe termopompave ne ndertesast qeveritare" me numër të prokurimit 214-24-4897-1-1-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Ejona" Sh.P.K.

## Arsyetim

### *- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Me 28.05.2024, Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Ndërsa me datën 29.08.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate OE “Termo Solar Engineering SH.P.K.”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim me vlerë të parashikuar të kontratës 194,500.00 euro.

Me 23.09.2024, OE “Ejona” Sh.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 06.09.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 16.09.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Ejona” Sh.P.K. me numër protokolli 2024/0858 lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi dhe montimi i chilereve te rinj dhe termopompave ne ndertesast qeveritare me numër të prokurimit 214-24-4897-1-1-1.

### *-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Ejona” Sh.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (1) : “AK kërkon sqarime shtese për dokumente te cilat nuk kane qene kërkesë e DT dhe as e Njoftimit për kontratë, duke shkelur kështu Nenin 72. përkatësisht, paragrafi 1) Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohej ose pranohet nga autoriteti kontraktues ose të ofrohet nga një tenderues. dhe Neni 40 - RrPP paragrafi 40.2. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Ne ju kemi përgjigjur AK me një deklaratë ku kemi saktësuar se kërkesa e tyre është në kundërshtim me LPP dhe RrPP si dhe kemi konfirmuar edhe njëherë se produktet dhe shërbimet e ofertuar janë në përputhje të plote me specifikimet teknike, ashtu si edhe deklarata për specifikime teknike që e kemi dorëzuar para hapjes. Po ashtu kemi deklaruar se, katalogun do e dorëzojmë pas nënshkrimit të kontratës dhe vizitës në teren për aprovim nga AK ashtu edhe siç bëjmë ne të gjitha projektet tjera, e posaçërisht me këtë AK...”

Pretendimi i dytë (II) : “AK shkel Nenin 59 te LPP dhe Nenin 40 te RrPP duke mos kryer Ekzaminimin, Vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas ligjit. Pra, AK përveç se kërkon ndryshime te dokumenteve para hapjes AK po ashtu shton kritere te reja gjate ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit te tenderëve, dhe i përdor ato kritere te sajua për eliminimin tone nga gara, veprim ky plotësisht i ndaluar nga LPP. AK me vendimin e shpallur shkele plotësisht Nenin 59 dhe 40 duke vlerësuar ofertat ne baze te kritereve qe nuk kane qene ne DT dhe as ne Njoftimin për kontratë, dhe për te njëjtat kritere eliminon nga gara dy OE qe kane ofertuar me çmim me te ulet dhe e shpalle fitues OE me çmim me te larte se ne prej 35,188.12euro duke dëmtuar kështu direkt buxhetin e RKS. AK po ashtu shpall fitues një OE i cili ka dorëzuar katalog mirëpo, i njëjti nuk i plotëson kërkesat minimale te produktit te kërkuar.”

Pretendimi i tretë (III) : “AK shkel Nenin 56, paragrafi 3 duke na diskualifikuar nga gara ne baze te një kriteri i cili nuk është cekur ne DT dhe Njoftim për kontratë..”

Duke u referuar kërkesave si më sipër OE “Ejona” Sh.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me neni 56, 59, 72 të LPP-së si dhe neni 40 të Rrpp-së. Kërkojmë nga OSHP qe te anuloje vendimin e shpallur, te ktheje lenden ne rivlerësim dhe te detyroje AK te beje Ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin sipas LPP dhe RrPP. Kjo tashme është lënda e dyte qe e kemi dorëzuar ne OSHP për te njëjtin AK dhe për te njëjtat arsye te eliminimit, andaj këto veprime te AK duket se janë shume tendencioze ndaj nesh

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: “Pretendimi i tenderuesit ankues "Ejona" Sh.P.K, Pejë, thotë se AK me rastin e vlerësimit te tenderëve, ka shkelur Neni 72 LPP-se. Autoriteti Kontraktues pasi ka shqyrtuar me kujdes kërkesën për rishqyrtim, konstaton edhe ne here se nuk qëndron pretendimet e ankuesit, sepse AK gate vlerësimit te tenderëve për këtë aktivitet të prokurimit iu ka përmbajtur dhe ka zbatuar nenin 59 par. 2 te LPP-se, dhe nenit 72, për arsye se gjatë procedurës së ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit te tenderëve Komisioni i vlerësimit te ofertave me qellim me te mire që te behet vlerësimit i saktë dhe si duhet, bazuar ne nenin 59 dhe 72 te LPP me datën 22.07.2024 përmes letrës standarde ka kërkuar informacione shesë “Katalog me specifikim teknik për produktet e ofruara nga te gjithë OE pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit - Te gjithë tenderuesit pjesëmarrës kane dorëzuar katalog me specifikim detaj, përveç juve “Ejona ShPK”, qe nuk keni dorëzuar katalog e as specifikim teknik për mallrat e ofruara. Kjo situatë ishte e sqaruar dhe mbështetur ne Udhëzuesin Nr.001/2023 për Prokurimin Publik Neni 10. Sqarimi i tenderëve gate procesit te vlerësimit të tenderëve 10.1 Shembujt e mëposhtëm nuk janë te vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet te veprojnë në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 te LPP-se. Bazuar ne Udhëzuesin 001/2023 ku thuhet qe : Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu ("specifikimit teknik" - AK përcaktuar kërkesat minimale dhe maksimale te Një produkti, ndërsa OE duket te dorëzojë specifikimin e detajuar te mallrave te ofruara. Përveç ne raste kur OE nuk mund te dorëzojë specifikimin teknik te një produkti te caktuar p.sh. peme/ perime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaronte se mallrat do te jene ne përputhje me specifikimin e kërkuar), Sipas paragrafit 2 te nenit 52 te LPP ku thuhet se : Autoriteti kontraktues mundet qe me shkrim te kërkojë nga nje tenderues de te sigurojë një sqarime me shkrim mbi cilindo nga aspektet & tenderit te tij, ne mënyrë qe te behet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve, mbi këtë baze (neni 59 pika 2 e LPP-se) komisioni ka kërkuar sqarime shtese tek tenderuesi IJONA SHPK, duke kërkuar katalog se bashku me specifikim te detajuar teknik për mallrat e ofruara, ndërsa i njëjti edhe pas kërkesës për sqarim nuk ki dorëzuar as katalog e as specifikim teknik te mallrave le ofruara duke deklaruar se nuk kane qene kërkesë ne dosjen e tenderit. Pavarësisht qe nuk ka qene kërkesë ne

dosjen e tenderit bazuar ne nenin 59 pika 2 dhe sipas Udhëzuesin 001/2023 për Prokurim Publik tenderuesi ka qene i obliguar te paraqesë specifikimin teknik te detajuar e jo te dorëzoj vetëm deklaratë mbi specifikimet teknike, sepse këto mallra nuk janë peme dhe perime qe te dorëzoj vetëm deklaratë për specifikim teknik. Si rrjedhojë komisioni i vërsimit nuk ka mundur te vlerësoi ofertën teknike te produkteve te ofruara me ato te kërkuara, sepse edhe pas kërkesës për sqarime i njëjti nuk ka ofruar asnjë dëshmi me çfarë produktesh oferton, ne mënyrë qe te konstatohet perputhshmeria me specifikimin teknik te kërkuar nga AK-MPB dhe ofertës teknike te ofruar, andaj me te drejt komisioni ka vendosur për eliminimin ofertës tuaj. Pretendimi i kompanisë se janë kërkuar sqarime shpese qe nuk kane qene ne dosjen e tenderit e as ne njoftimin për kontrate, nuk qëndron për arsye se ne kemi kërkuar sqarim vetëm për artikujt e specifikuar qe kane qenë ne dosjen e tenderit dhe çdo sqarim duhet te dëshmohet me ndonjë dokument, e qe ne këtë rast i vetmi dokument qe dëshmon dhe sqaron është katalogu dhe specifikimi teknik për artikujt e ofruar. Deklarata e Tenderuesit ankues se: katalogun do e dorëzojnë pas nënshkrimit te kontratës për aprovim nga AK ashtu ehe siç bëjmë ne te gjitha projektet tjera, nuk ka baze ligjore sepse ne dosjen e tenderit nuk është theksuar e as lejuar se produktet te ndryshme pas nënshkrimit te kontratës dhe po ashtu nuk janë lejuar variantet siç pretendon operatori ekonomik qe to propozoi produkte te ndryshme pas nënshkrimit te kontratës deri ne aprovim nga ana e AK. Për neve si AK-MPB është befasuese se si ka mundësi një operator ekonomik te oferton për artikujt si janë chileret për ftohje dhe ngrohje dhe i njëjti nuk ka specifikim teknik te artikujve nga prodhuesi me çka oferton dhe as katalog dhe po ashtu kundërshton dorëzimin e specifikimit teknik me katalog edhe pas kërkesës nga AK-MPB. Andaj komisioni i vlerësimit te ofertave me te drejt ka vendosur për eliminimin tuaj dhe ky pretendim është i pa bazuar.

2. Përgjigje ne pretendimin 2 te larte cekur) Pretendim i tenderuesit ankues Ejona Sh.P.K, se nuk është shkel Nenin 59 te LPP-se dhe Nenin 40 te RrPP me rastin e vlerësimit të tenderëve AK-MPB ka shqyrtuar pretendimin tenderuesit ankues dhe konstaton se këto pretendime nuk janë te bazuara dhe nuk kemi te bëjmë me shkelje te neneve te përmendura ne këtë pretendim, sepse AK-MPB (komisioni i vlerësimit) nuk ka kërkuar ndryshime ne dokumente dhe nuk ka vendosur kriteret tjetër por bazuar ne paragrafit 2 te nenit 52 te LPP ku thuhet se : "Autoriteti kontraktues mundet qe me shkrim te kërkojë nga një tenderues që te sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit te l, ne mënyrë de te behet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve: " Sqarimet e kërkuar nuk kane to bëjnë me kriteret te përzgjedhjes apo shtim te kriterëve por janë vlerësim dhe sqarim për artikujt te kërkuar ne specifikimin teknik ne dosjen e tenderit , andaj ky pretendim është i pa bazuar. Gjithashtu pretendimi i Tenderuesit ankues se OE i përzgjedhur fitues nuk plotëson kërkesat teknike produkti tek Pompa termike dhe qe nuk i plotëson kërkesat sipas specifikimit teknik, AK-MPB ka shqyrtuar këtë pretendim dhe gjithashtu ka shikuar edhe krahasuar katalogun e OE te përzgjedhur fitues, LPP ka vërejtur pas kërkesës për qasje dhe dorëzimit te dokumenteve "katalogut te OE fitues" tek tenderuesi ankues, gabimisht nuk janë përcjell te gjitha materialet e katalogëve për shaka se OE fitues ka dorëzuar disa foldera ndaras te katalogëve dhe gjate dorëzimit pa ndonjë qellim është harruar katalogu për pompa termike te qe do ti bashkëngjisim këtij vendimi një pjese te katalogot te dërguar me datës 25.07.2024). Megjithatë pas shikimit dhe krahasimit te katalogut te OE te përzgjedhur fitus me kërkesat minimale te artikujve te kërkuar me specifikimin teknik ne Aneksin 1 te DT dhe FTD konstaton se ky produkt i plotëson te gjitha specifikimet teknike te kërkuar andaj pretendimi ankimor ne këtë pike është i pa bazuar.

3. Përgjigje në pretendimin 3 te lartcekur Pretendimi i tenderuesit ankues se AK shkel Nenin 36, paragrafi 3 duke na diskualifikuar nga gara ne baze te një kriteri i cili nuk është cekur ne DT dhe Njoftim për Kontrate. AK-MPB ka shqyrtuar pretendimin e Tenderuesit ankues dhe konstaton se këto pretendime nuk janë te bazuara dhe nuk kemi te bëjmë me shkelje te neneve te përmendura ne këtë pretendim, sepse AK-MIB (komisioni i vlerësimit)

nuk ka kërkuar ndryshime ne dokumente dhe nuk ka vendosur kritere tjetër, por bazuar ne paragrafit 2 te nenit 52 te LPP ku thuhet se “Autoriteti kontraktues mundet qe me shkrim te kërkojë nga një tenderues qe të siguroj një sqarim me shkrim dhe cilindo nga aspektet e tenderit te ty ne mënyrë qe te behet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve. Andaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 25/09/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0858/2024, ndërsa me datë 07/10/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0858 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është Pajtuar lidhur me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është Pajtuar pjesërisht lidhur me mendimin e ekspertit .

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Ejona” Sh.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0858 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i pare (I) : “Eksperti shqyrtues sqaron që sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, AK në asnjë kërkesë nuk ka potencuar se operatorët ekonomik ofertues duhet të dorëzojnë edhe katalogun/broshurën apo specifikacionin teknik për produktet e ofertuara. Kërkesa të tilla nuk janë parë as në Aneksi 1-Specifikimet teknike të detyrueshme. AK me datën 22/07/2024 ka dërguar një letër standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit, përmes të cilit autoriteti ka kërkuar nga OE ankues dhe operatorët tjerë që të dorëzojnë katalogët nga prodhuesi për pozicionet 1-6 së bashku me përshkrimin e karakteristikave të produkteve. Si përgjigje ndaj kësaj kërkesë OE ankues me datën 25/07/2024 ka dorëzuar një deklaratë përmes të cilës ndër të tjerash thuhet se pas konsultimit me KRPP-në ju rikujtojmë se AK ka të drejtë të kërkoj informacione shtesë vetëm për dokumentet të cilat janë kërkuar dhe për dokumentet që janë paraqitur gjatë fazës së tenderimit dhe se pas nënshkrimit të kontratës katalogjet do të dorëzohen për aprovim për produktet e ofertuara. Sipas nenit 56 të Ligjit për Prokurimin Publik, pika 3 e këtij neni ku thuhet se asnjë tenderues nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, atëherë edhe mendimi i ekspertit shqyrtues është se në rastin konkret AK nuk duhet të kërkoj sqarime për kritere shtesë dhe i njëjti nuk ka të drejtë të eliminoj operatorët ofertues në bazë të kriterëve të reja të cilat më herët nuk kanë qenë pjesë e njoftimit

për kontratë dhe dosjes së tenderit. Megjithatë, duke marrë parasysh natyrën e aktivitetit të prokurimit, përmes të cilit autoriteti kontraktues edhe pse në dosje nuk e ka përfshirë këtë kërkesë, sipas mendimit të ekspertit është e vështirë për AK-në që të vlerësoj ofertat duke mos e pasur të qartë as prodhuesin dhe as modelin e produkteve me të cilat ofertohet. Në rastin konkret sipas ekspertit konsiderojmë që nëse AK nuk ka të drejtë të shtoj kërkesa të cilat nuk kanë qenë në NJK dhe DT, atëherë të paktën operatori ankues mund të dorëzoj një deklaratë me të cilën sqaron se cilit prodhues dhe cilit model i takojnë produktet me të cilat ka ofertuar. Nga kjo çfarë sqaruar konsiderojmë që pretendimi i ngritur është pjesërisht i bazuar.”

Konstatimi i dytë (II) : “Sa i përket këtij pretendimi, OE ankues në ankesë nuk ka qenë aspak i qartë se cilat kërkesa të cilit produkt nuk i plotëson katalogu i dërguar përmes sqarimeve shtesë nga ana e operatorit të rekomanduar, megjithatë në dokumentet e ofruara si dëshmi eksperti ka parë se janë shtjelluar disa specifika të disa produkteve për të cilat edhe AK ka dhënë përgjigje se i ka dhënë qasje OE ankues gabimisht vetëm në njërin katalog andaj sipas tyre edhe pretendimet e ngritura janë bazuar në katalogun e gabuar. Në këtë rast eksperti vlerëson që pas kthimit të lëndës në rivlerësim duhet që të njëjtit ti ofroj qasje edhe në katalogun e dytë në mënyrë që të ngriten pretendimet konkrete duke u bazuar në katalogjet adekuate. Në rastin konkret konsiderojmë që ky pretendim është pjesërisht i bazuar.”

Konstatimi i tretë (III): “Për këtë çështje eksperti shqyrtues ka dhënë përgjigje në pretendimin e parë dhe e njëjta përgjigje vlenë edhe në këtë pretendim të ngritur.”

#### ***- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –***

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi dhe montimi i chilereve të rinj dhe termopompave në ndertesast qeveritare me numër të prokurimit 214-24-4897-1-1-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Ejona” Sh.P.K dhe se Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit, si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Ejona” Sh.P. K janë pjesërisht të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Furnizimi dhe montimi i chilereve të rinj dhe termopompave në ndertesast qeveritare me numër të prokurimit 214-24-4897-1-1-1, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit e sheh si pjesërisht të bazuar, duke rekomanduar

që aktiviteti i prokurimit me Furnizimi dhe montimi i chilereve te rinj dhe termopompave ne ndertesat qeveritare me numër të prokurimit 214-24-4897-1-1-1 që lënda të kthehet në rivlerësim dhe AK-ja të veproj në raport me dispozitat ligjore të LPP-së sipas kërkesave të Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Batisha Ibrahim**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- **OE - " EJONA " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: